



## EKSPOZE

### Mbi krijimin dhe funksionimin e Unionit Stop Krimit

#### VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me 16.02.2015 , **une Ervin Pollozhani** , Gjyqtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor, Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga **Z. Maksim Ferra** , ne cilesine e Drejtorit Ekzekutiv te Shoqates “UNIONI STOP KRIMIT”, me seli ne adresen: Rruga Naim Frasheri, nr. 10, Tirane, Shqiperi, per regjistrimin e kesaj shoqate dhe depozitimi i akteve themeluese ne Regjistrin e Organizatave Jofitimpruese,

#### VENDOSA:

Pranimin e kerkeses. Regjistrimin e shoqates me emertimin “**UNIONI STOP KRIMIT**” e cila eshte nje organizate jofitimpruese e themeluar ne formen e shoqates sipas dispozitave te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise dhe ligjit nr. 8788, date 07.05.2001 “Per Organizatat Jofitimpruese”, nga Mbledhja Themeluese e finalizuar ne date 06.01.2015.

#### Qellimi.....

eshte ai sipas statutit bashkelidhur por kryesisht Lufta Kunder Krimit te çdo lloji dhe ne veçanti:

- Të ndihmojë në studimin identifikimin dhe përshtatjen në kushtet e Shqipërisë të formave dhe metodave të reja të parandalimit e luftës ndaj krimit, në bashkëpunim me qendra dhe organizata të vendit, rajonale e ndërkombëtare.
- Të kontribuojë në shkallë vendi e qarku në përpjekje për ndërtimin e një fronti të përbashkët rajonal e më gjerë, për parandalimin dhe luftën kundër krimit të rrugës, shpërndarjes së drogave nëpër territoret e shkollave, bullizmit, trafikeve të paligjshme me fokus të rrinte dhe të miturit.

- Të ofrojë ekspertizë të kualifikuar për viktimat e krimit me ekspertët dhe anëtarët e saj në bashkëpunim me organet e specializuara shtetërore. Të ofrojë shërbime të specializuara me ekspertë për viktimat e mitura të krimit
- Të përfshijë dhe trajtojë ata qytetarë shqiptarë që janë të përkushtuar për mbrojtjen e demokracisë, të shtetit ligjor dhe të komuniteteve të tyre nga veprimtaria kriminale, duke i përfshirë si vullnetarë, ose si aktivistë të kualifikuar në projekte studimore e vepruese proaktive.
- Të shkëmbejë dhe ofrojë eksperiencat dhe bashkëpunimet e anëtarëve të saj me agjencitë të specializuara shtetërore të zbatimit të ligjit, policisë, shërbimit informativ si dhe agjencive private të sigurisë brenda e jashtë vendit për parandalimin e krimit dhe edukimin e komuniteteve.
- Të studiojë shkaqet, dukuritë dhe fenomenet e lindjes dhe zhvillimit të krimit në Shqipëri dhe në radhët e komuniteteve shqiptare në emigracion si dhe mundësinë e dokumentimit, parandalimit dhe luftës kundër krimi, duke ruajtur dhe mbrojtur sipas ligjit privacinë e burimeve të informacionit.
- Të bashkëpunojë për parandalimin e krimit ndërkombëtar nëpërmjet shkëmbimit të përvojave mes anëtarëve dhe organeve të tjera të sigurisë të vendeve të BE dhe jo të BE, sipas ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fuqi.
- Të studiojë dhe shkëmbejë analiza e statistika, të dhëna dhe projekte në fushat e sigurisë kombëtare e ndërkombëtare, për një trajtim alternativ të problemeve shkencore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të miturve nga trafikimi, në lidhje me birësimet, shfrytëzimin seksual, trafikun e organeve dhe përfshirja e shtetasve shqiptarë brenda dhe jashtë vendit në organizatat kriminale shqiptare e ndërkombëtare.
- Të ndër marrë kërkime dhe studime në fushën e krimit kompjuterik, me fokus të veçantë në ndikimet tek të miturit e të rinjtë, për të parandaluar viktimizimin e tyre nga veprat e reja penale kombëtare dhe ndërkombëtare të fushës.
- Të studiojë, të shkëmbejë analiza e statistika, të dhëna e projekte në fushat e luftës kundër përdorimit të armëve biologjike e kimike, si dhe të mjeteve e materialeve që përdoren për identifikimin e personave që i posedojnë e trafikojnë ato.
- Të kontribuojë në bashkëpunim edhe me organizata të tjera homologe kombëtare e ndërkombëtare në identifikimin e formave dhe metodave të reja për parandalimin dhe luftën kundër krimit.

.....

### **Organet Drejtuese të Unionit "STOP KRIMIT" (SCU) janë:**

1. Asambleja e Përgjithshme e anëtarëve dhe ekspertëve.
2. Bordi i Këshillimit.
3. Drejtori Ekzekutiv.
4. Bordet këshillimore të filialeve, në komunitetet shqipfolëse, të miratuara sipas ligjeve të shteteve respektive.

Organi më i lartë vendimmarrës është Asambleja e Përgjithshme dhe midis dy mbledhjeve të saj është Drejtori Ekzekutiv me këshillimin e Bordit të këshillimit Asambleja e Përgjithshme thirret një herë në 5 vjet. Ajo zhvillohet kur janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve të Unionit "STOP KRIMIT" (SCU). Asambleja kryesohet nga Drejtori Ekzekutiv.

Selia e Unionit do të jetë në rrugën "Naim Frashëri", Nr.10, Tiranë. Me Vendimin e Bordit këshillimor, Unioni mund të hapë zyra dhe të caktojë përfaqësuesë në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë shtetit.

- Tirane me dt. 16.02.2015

GJYQ TAR  
ERVIN POLLOZHANI

### **Sqarim:**

UNIONI është dhe një Bashkim i Filialeve, Degeve dhe Qendrave Shqiptare të Studimit të Luftes Kundër Terrorizmit dhe Krimit të Organizuar të ngritur që nga viti 2005 e deri më sot për komunitetin shqiptar kudo që ndodhen në emigrim

## **Pjese nga Akti i Themelimit dhe Statutit të UNIONIT STOP KRIMIT**

### **AKT - THEMELIMI UNIONI "STOP KRIMIT"**

(Qendër studimore dhe sensibilizimi për parandalimin e krimit  
në radhët e komunitetit shqiptar, kudo që ndodhen, e quajtur shkurtimisht "SCU")  
**SELIA KOMBËTARE, SHQIPËRI**

#### **NENI 1 Lloji dhe emri**

Është themeluar Organizata Jofitimpruese e quajtur UNIONI "STOP KRIMIT" (qendër studimore dhe sensibilizimi për parandalimin e krimit në radhët e komunitetit shqiptar kudo që ndodhen si në Shqipëri, ashtu dhe në emigracion e quajtur shkurtimisht SCU).

#### **NENI 2 Selia**

Selia e Unionit do të jetë në rrugën "Naim Frashëri", Nr.10, Tiranë. Me Vendimin e

Bordit këshillimor, Unioni mund të hapë zyra dhe të caktojë përfaqësuesë në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë shtetit.

### NENI 3

#### *Identiteti i Themeluesit*

Grupi nismëtar u mblodh për të formuar Bordin e këshillimor si më poshtë:

- |                   |   |  |
|-------------------|---|--|
| 1. Maksim Ferra   | - | Drejtor Ekzekutiv  |
| 2. Anesti Xhexhi  | - | anëtar, ekspert i sigurisë publike                       |
| 3. Ylli Toska     | - | anëtar, ekspert i koordinimit për filialet               |
| 4. Selami Nelaj   | - | anëtar, ekspert i sigurisë publike                       |
| 5. Arqile Kosta   | - | anëtar, ekspert i trajnimit dhe edukimit                 |
| 6. Arben Plasa    | - | anëtar, konsulent për fëmijët e humbur e të trafikuar    |
| 7. Enriko Ceko    | - | anëtar, ekspert i marrëdhënieve publike dhe masmedian    |
| 8. Gazmend Dardha | - | anëtar, konsulent i Forumit Rinor “Miq të Policisë”      |
| 9. Igli Qoshja    | - | anëtar, ekspert i menaxhimit të projekteve dhe financave |

### NENI 4

#### *Misioni, objektivat dhe fusha e veprimtarisë*

##### **1. Misioni:**

UNIONI “STOP KRIMIT” (SCU) është organizatë e pavarur jofitimprurëse (OJF) studimore dhe vepruese e themeluar në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, e cila nuk ndjek qëllime ekonomike, por për realizimin e Misionit dhe objektivave të veprimtarisë të përshkruar në Statutin e saj ka të drejtë të ushtrojë çdo veprimtari të ligjshme ekonomike. Kur ushtrimi i një veprimtarie paraprihet nga nevoja për marrjen e një leje apo licence, nëpërmjet një personi të autorizuar do t'i paraqesë kërkesën organit përgjegjës. Ajo ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe në bashkëpunim me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare për studimin, parandalimin dhe luftën kundër krimit, të cilat kanë qëllime të njëjta si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ashtu dhe jashtë saj.

.....

### NENI 5

#### *Synimet*

##### **3. Duke ndjekur objektivat e mësipërme, UNIONI:**

- Kryen studime dhe jep konsulencë ligjore për anëtarët e komuniteteve shqipfolëse kudo që ndodhen, në Shqipëri dhe në vendet ku janë rezidentë në emigracion.
- Organizon seminare, trajnime, konferenca, leksione dhe shkëmben informacione me

interes me organet e specializuara të shtetit shqiptar dhe të shteteve ku ka shqiptarë rezidentë në emigracion për parandalimin dhe luftën kundër krimit.

- Ndhmon në sensibilizimin, njohjen dhe zbatimin e Ligjit, të drejtave dhe detyrimeve si shtetas dhe si anëtarë të kësaj organizate, duke pranuar se qenia anëtar i këtij Unioni nuk sjell përfitime personale, përveç detyrave dhe asnjë privilegj që cenon apo bie ndesh me Ligjet, aktet normative dhe vetë Statusin e Unionit.

- Ndhmon në sensibilizimin e organeve shtetërore dhe opinionin publik për domosdoshmërinë e bashkëpunimit me organet përgjegjëse shtetërore të parandalimit dhe luftës kundër krimit, dhunës ndaj grave dhe shfrytëzimit të fëmijëve

- Ngre dhe mirëmban qendra për rehabilitimin e viktimave të mitur të trafikimit, të fëmijëve të rrugës dhe atyre në nevojë.

- Boton një revistë periodike shkencore, faqe interneti dhe mban kontakte të vazhdueshme me shtypin e specializuar të fushës së parandalimit dhe të luftës kundër krimit brenda dhe jashtë vendit.

- Boton dhe shpërndan fletëvolante, fletëpalosje e postera sensibilizimi dhe këshillimi, me fokus në parandalimin dhe luftën kundër fenomeneve kriminale që cenojnë sigurinë dhe qetësinë e komuniteteve dhe grupeve të interesit.

.....

### **Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve**

1. Unioni është i frymëzuar nga parimet e të Drejtave Humane Universale, të Demokracisë, Barazisë para Ligjit dhe Lirisë.

2. Anëtarët e zakonshëm janë të detyruar të paguajnë detyrimet vjetore:

3. Të gjithë anëtarët janë të detyruar në përputhje me dispozitat e Statutit të Unionit të zbatojnë Kodin e Etikës, i cili përbën bazën e vlerave të ndërtimit të Misionit, Qëllimeve dhe Objektivave.

4. Anëtari mundet, në çdo kohë dhe pa të drejtën e tërheqjes së kuotës vjetore të anëtarësisë, të tërhiqet nga Unioni, me anë të një kërkesë të bërë 15 ditë përpara.

5. Çdo anëtar ka të drejtën të një vote të vetme në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

### ***Përfundimi i anëtarit***

Anëtarët mund të përjashtohen në rast të mos zbatimit të detyrimeve të Statutit dhe

shkeljes së Kodit të Etikës.

### **Normat e aderimit ne organizate.**

Në Unionin Stop Krimet ( SCU ) mund të aderojnë si anëtarë të gjithë ata shtetas shqiptarë, që pranojnë misionin, qëllimet dhe Statutin në tërësinë e tij. Ata duhet të paraqesin një kërkesë, sipas rregullave të vendosura në Statut dhe pranohen ose refuzohen në momentin e paraqitjes së kërkesës. Kuota e anëtarësimit nuk është e kthyeshme ose e transferueshme dhe përdoret për shërbimet e kancelarisë.

-----

**STATUTI**  
**UNIONI “STOP KRIMIT”**  
**(SCU)**

**Qendra studimore dhe sensibilizuse e parandalimit të krimit në radhët e komunitetit shqiptar, kudo që ndodhen**

.....

**NENI 2**  
***Objekti***

Nepermjet studimeve dhe investigimeve te grumbulloj informacione nga burimet e hapura dhe ato konfidenciale ne radhet e komunitetit shqiptar kudo qe ndodhen si ne Shqiperi dhe ne emigracion, per parandalimin e krimit te organizuar dhe terrorizmit ne radhet e ketij komuniteti me ane te dokumentimit dhe informimit ne kohe te organeve kompetente brenda kornizave ligjore kombetare dhe nderkombetare sipas marreveshjeve te bera midis ketyre organeve homologe shteterore dhe private me Unionin Shqiptar Antikrim duke ruajtur anonimatit e burimit te informacionit. Te krijoj mundesine per te ndihmuar agjensite e zbatimit te Ligjit per menaxhimin me më aftesi dhe me më efektivitet te burimeve njerezore te komunitetit shqiptar kudo qe ndodhen, me qellim qe keto agjenci te rrisin pergjegjesite e tyre per parandalimin e reziqeve te krimit te organizuar dhe terrorizmit ne Shqiperi dhe ne radhet e komunitetit shqipfoles ne vendet ku jane rezident.

.....

**NENI 5**  
***Rezidenca dhe kushtet e funksionimit***

- Unioni ka seline ne adresen: rruga Naim Frasheri nr.10 Tirane. Me vendim te Bordit te Drejtoreve, Unioni mund te hape zyra dhe te emeruje perfaqesues edhe ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte shtetit.
- Ushtron veprimtarine ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe ne te gjitha shtetet ku ka komunitet shqipfoles .
- Veprimtaria e tij mbeshtetet ne aktet themelore kushtetuese dhe ligjeve ne fuqi te Republikes se Shqiperise dhe te atyre shteteve ku jane ngritur filialet dhe qendra te tjera homologe me te njejtin mision.
- Unioni fillon aktivitetin e tij me regjistrimin ne gjykatën e rrethit Tirane.
- Anetaret e ketij Unioni mund te bejne pjese ne cdo parti politike apo organizata te tjera te ligjeshme qe nuk bien ne kundërshtim me programin e saj.

**1. Misioni:**

UNIONI “STOP KRIMIT” (SCU) është organizatë e pavarur jofitimprurëse (OJF) studimore dhe vepruese e themeluar në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, e cila nuk ndjek qëllime ekonomike, por për realizimin e Misionit dhe objektivave të veprimtarisë të përshkruar në Statutin e saj kë të drejtë të ushtrojë çdo veprimtari të ligjshme ekonomike. Kur ushtrimi i një veprimtarie paraprihet nga nevoja për marrjen e një leje apo licence, nëpërmjet një personi të autorizuar do t'i paraqesë kërkesën organit përgjegjës. Ajo ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe në bashkëpunim me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare për studimin, parandalimin dhe luftën kundër krimit, të cilat kanë qëllime të njëjta si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ashtu dhe jashtë saj.

**2. Objektivat e veprimtarisë së UNIONIT “STOP KRIMIT” (SCU) janë:**

- Të ndihmojë në studimin identifikimin dhe përshtatjen në kushtet e Shqipërisë të formave dhe metodave të reja të parandalimit e luftës ndaj krimit, në bashkëpunim me qendra dhe organizata të vendit, rajonale e ndërkombëtare.
- Të kontribuojë në shkallë vendi e qarku në përpjekje për ndërtimin e një fronti të përbashkët rajonal e më gjerë, për parandalimin dhe luftën kundër krimit të rrugës, shpërndarjes së drogave nëpër territoret e shkollave, bullizmit, trafikeve të paligjshme me fokus të rrinte dhe të miturit.
- Të ofrojë ekspertizë të kualifikuar për viktimat e krimit me ekspertët dhe anëtarët e saj në bashkëpunim me organet e specializuara shtetërore. Të ofrojë shërbime të specializuara me ekspertë për viktimat e mitura të krimit
- Të përfshijë dhe trajnojë ata qytetarë shqiptarë që janë të përkushtuar për mbrojtjen e demokracisë, të shtetit ligjor dhe të komuniteteve të tyre nga veprimtaria kriminale, duke i përfshirë si vullnetarë, ose si aktivistë të kualifikuar në projekte studimore e vepruese proaktive.
- Të shkëmbejë dhe ofrojë eksperiencat dhe bashkëpunimet e anëtarëve të saj me agjencitë të specializuara shtetërore të zbatimit të ligjit, policisë, shërbimit informativ si dhe agjencive private të sigurisë brenda e jashtë vendit për parandalimin e krimit dhe edukimin e komuniteteve.
- Të studiojë shkaqet, dukuritë dhe fenomenet e lindjes dhe zhvillimit të krimit në Shqipëri dhe në radhët e komuniteteve shqiptare në emigracion si dhe mundësinë e



dokumentimit, parandalimit dhe luftës kundër krimi, duke ruajtur dhe mbrojtur sipas ligjit privacinë e burimeve të informacionit.

- Të bashkëpunojë për parandalimin e krimit ndërkombëtar nëpërmjet shkëmbimit të përvojave mes anëtarëve dhe organeve të tjera të sigurisë të vendeve të BE dhe jo të BE, sipas ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fuqi;

- Të studiojë dhe shkëmbejë analiza e statistika, të dhëna dhe projekte në fushat e sigurisë kombëtare e ndërkombëtare, për një trajtim alternativ të problemeve shkencore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të miturve nga trafikimi, në lidhje me birësimet, shfrytëzimin seksual, trafiku i organeve dhe përfshirja e shtetasve shqiptarë brenda dhe jashtë vendit në organizatat kriminale shqiptare e ndërkombëtare.

- Të ndërmarrë kërkime dhe studime në fushën e krimit kompjuterik, me fokus të veçantë në ndikimet tek të miturit e të rinjtë, për të parandaluar viktimizimin e tyre nga veprat e reja penale kombëtare dhe ndërkombëtare të fushës.

- Të studiojë, të shkëmbejë analiza e statistika, të dhëna e projekte në fushat e luftës kundër përdorimit të armëve biologjike e kimike, si dhe të mjeteve e materialeve që përdoren për identifikimin e personave që i posedojnë e trafikojnë ato.

- Të kontribuojë në bashkëpunim edhe me organizata të tjera homologe kombëtare e ndërkombëtare në identifikimin e formave dhe metodave të reja për parandalimin dhe luftën kundër krimit.

## NENI 5 *Synimet*

### **3. Duke ndjekur objektivat e mësipërme, UNIONI:**

- Kryen studime dhe jep konsulencë ligjore për anëtarët e komuniteteve shqipfolëse kudo që ndodhen, në Shqipëri dhe në vendet ku janë rezidentë në emigracion.

- Organizon seminare, trajnime, konferenca, leksione dhe shkëmben informacione me interes me organet e specializuara të shtetit shqiptar dhe të shteteve ku ka shqiptarë rezidentë në emigracion për parandalimin dhe luftën kundër krimit.

- Ndhmon në sensibilizimin, njohjen dhe zbatimin e Ligjit, të drejtave dhe detyrimeve si shtetas dhe si anëtarë të kësaj organizate, duke pranuar se qenia anëtar i këtij Unioni nuk sjell përfitime personale, përveç detyrave dhe asnjë privilegj që cenon apo bie ndesh me Ligjet, aktet normative dhe vetë Statusin e Unionit.

- Ndhmon në sensibilizimin e organeve shtetërore dhe opinionin publik për domosdoshmërinë e bashkëpunimit me organet përgjegjëse shtetërore të parandalimit dhe luftës kundër krimit, dhunës ndaj grave dhe shfrytëzimit të fëmijëve
- Ngre dhe mirëmban qendra për rehabilitimin e viktimave të mitur të trafikimit, të fëmijëve të rrugës dhe atyre në nevojë.
- Boton një revistë periodike shkencore, faqe interneti dhe mban kontakte të vazhdueshme me shtypin e specializuar të fushës së parandalimit dhe të luftës kundër krimit brenda dhe jashtë vendit.
- Boton dhe shpërndan fletëvolante, fletëpalosje e postera sensibilizimi dhe këshillimi, me fokus në parandalimin dhe luftën kundër fenomeneve kriminale që cenojnë sigurinë dhe qetësinë e komuniteteve dhe grupeve të interesit.

## NENI 7

### ***Burimet financiare dhe disponibiliteti i fondeve***

#### **Burimet ekonomike te Unionit**

Burimet ekonomike për funksionimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të Unionit janë:

- Kuota e anëtarësisë, sipas statutit
- Kontributet e jashtëzakonshme të anëtarëve ose e donacioneve private dhe trashëgimi
- Kontributet dhe rimbursimet e paguara nga qeverisja qendrore, në bazë të marrëveshjes apo kredi ose me anë të projekteve të financimit ose aktivitete:
- Financime dhe kontribute nga organizatave ndërkombëtare për projekte studimore, sensibilizimi dhe proactive
- Pasuritë e luajshme dhe të paluajshme në pronësi të UNIONIT “STOP KRIMIT”.
- Çdo e ardhur tjetër që kontribuon në rritjen e veprimtarisë shoqërore, për sa kohë që ajo është në përputhje dhe lejohet me ligj, akte normative ose rregullore.

.....

## NENI 9

Organi më i lartë ekzekutiv i Unionit “STOP KRIMIT” (SCU), është Drejtori Ekzekutiv. Ai

ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjet në fuqi, Kodin e Etikës, Statutin dhe Akt-Themelimin.

### **Drejtori Ekzekutiv:**

- a) siguron mbarëvajtjen financiare te organizatës dhe ushtrimin e veprimtarisë se saj ne përputhje me qëllimin e deklaruar;
- b) përfaqëson organizatën ne marrëdhëniet me subjektet, private, publike ose shtetërore, donatorët, klientët furnizues apo subjekte të tjera private, si dhe me të gjitha nivelet e qeverisjes që rregullojnë veprimtarinë e organizatës;
- c) bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme te Parandalimit te Pastrimit te Parave për te siguruar qe organizatat partnere dhe ato qe sigurojnë financim, shërbime dhe mbështetje materiale nuk përdoren apo manipulohen për qëllime kriminale.

## **NENI 10** **Anëtarësimi**

Si anëtarë te Unionit pranohen te gjithë ata persona qe janë te fushave te përmendura me lart, si dhe studente, punëtorë, emigrante, intelektuale si brenda dhe jashtë vendit te cilët plotësojnë kartelën e anëtarit, pranojnë Kodin e Etikës, Statutin dhe detyrimet që rrjedhin prej tij, pasi studiojnë dhe firmosin Kodin e Sjelljes së anëtarit.

### **Anëtarë ka për DETYRE:**

- Te respektoje Statutin, Programin dhe zbatoj Kodin e Etikes te Unionit.
- Te paguaj kuotizacionin e anëtarësimit .

### **Anëtarë ka te DREJTE:**

- 1) Të informohet për veprimtarinë e Unionit
- 2) Të heqë dore nga anëtarësimi duke njoftuar me shkrim 15 ditë përpara
- 3) Të gjithë anëtarët njihen me Kodin e Etikes dhe duhet ta nënshkruajnë atë.
- 4) Anëtarët pajisen me dokumentin e anëtarësimit.

.....

**UNIONI STOP KRIMIT**  
**DREJTORI EKZEKUTIV**  
**Maksim Ferra**

**Dt. 18 Shkurt 2015**